

VENDIM
Nr. 628, datë 25.9.2019

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË RISHIKIMIT TË STRATEGJISË SË
MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit të rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Vendimi nr. 269, datë 3.4.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dokumentit të rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes”, shfuqizohet.
3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

RISHIKIMI STRATEGJIK I MBROJTJES I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
KREU I

HYRJE

Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes (RSM) i Republikës së Shqipërisë është një proces ciklik kombëtar dhe ndërinstucional në nivelin strategjik. Kryeministri i Republikës së Shqipërisë ka iniciuar procesin e RSM-së, në maj të vitit 2017, bazuar në një analizë racionale të interesave dhe objektivave kombëtarë, zhvillimeve të reja në mjedisin e sigurisë, përfitimeve dhe detyrimeve nga sistemi i mbrojtjes kolektive dhe zhvillimit ekonomik e financiar të vendit.

Përditësimi i RSM-së është realizuar nëpërmjet studimeve, analizave dhe diskutimeve profesionale midis aktorëve kryesorë, në nivelin më të lartë, të institucioneve të sigurisë dhe të mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë.

RSM-ja përshkruan interesat strategjike kombëtarë dhe politikat e mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, trajton rëndësinë e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të sigurisë, evidenton sasinë dhe cilësinë e kapaciteteve që duhet të disponojnë Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), sipas skenarëve më të mundshëm të përdorimit të tyre, nëpërmjet argumentimit analitik të rolit të tyre në mjedisin e ri të sigurisë, për të bërë të mundur funksionimin si një forcë e mirëpajisur, e mirëtrajnuar dhe e aftë profesionalisht, për të realizuar misionin kushtetues.

RSM-ja paraqet bazën e zhvillimit të kapaciteteve të ardhshme dhe madhësinë e Forcave të Armatosura, si dhe përparësitë për transformimin e mëtejshëm të tyre për arritjen e synimeve dhe objektivave të përcaktuar në dokumentet strategjike.

Karakterit gjithëpërfshirës i RSM-së ka krijuar klimën e nevojshme të bashkëpunimit për zhvillimin e koordinuar të kapaciteteve kombëtare në fushën e sigurisë e të mbrojtjes, duke shmangur kapacitetet paralele, si dhe duke ruajtur më mirë balancat ndërmjet sasisë dhe cilësisë së forcës dhe burimeve në dispozicion të mbrojtjes.

Metodologjia e përdorur në zhvillimin e RSM-së është bazuar te modeli i vendeve aleate për planifikimin e mbrojtjes, i orientuar drejt përcaktimit dhe krijimit të kapaciteteve të kërkuara. RSM-ja bazohet në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, e cila jep vlerësimin e rreziqeve të

brendshme e të jashtme dhe fuqizimin e sektorit të mbrojtjes, Strategjinë Ushtarake, Programin e Qeverisë për rritjen e kapaciteteve të mbrojtjes, Planin Afatgjatë të Zhvillimit të FARSH-ve dhe Konceptin Strategjik të NATO-s, si dhe vijon me analizën e rrethanave që ndikojnë në sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare, gjithashtu ajo përcakton kapacitetet e nevojshme për realizimin e misionit kushtetues dhe detyrave kryesore të FARSH-ve.

RSM-ja, në mënyrë të përmbledhur, analizon dhe përshkruan të gjithë aktorët dhe faktorët që lidhen me sigurinë kombëtare dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë; kontekstin strategjik të sigurisë; qasjen gjithëpërfshirëse ndaj sigurisë dhe mbrojtjes; kapacitetet për zbatimin e politikës së mbrojtjes; burimet e mbrojtjes dhe sfidat e ardhshme.

KREU II MJEDISI I SIGURISË, KËRCËNIMET DHE RREZIQET

2.1 Mjedisi ndërkombëtar i sigurisë

Mjedisi ndërkombëtar i sigurisë është nën një presion të vazhdueshëm të kërcënimeve komplekse, shumëdimensionale dhe subjekt i ndryshimeve të papritura. Këto kërcënime dhe rreziqe, në mënyrë të paparashikuar, po ndryshojnë ndjeshëm natyrën, intensitetin dhe ndikimin ndaj sigurisë globale.

NATO-ja dhe aleatët po përballen me sfida të sigurisë, të cilat vijnë kryesisht nga lindja dhe jugu i saj. Ato janë krijuar nga aktorë shtetërorë, joshetërorë, individë, grupe dhe organizata, të cilët mund të projektojnë dhe të realizojnë objektivat e tyre me pasoja dhe efekte të pallogaritshme për sigurinë në nivel global, rajonal e lokal. Burimet e destabilitetit në nivel global janë të shumta, karakteristike e të cilave është përhapja e tyre me shpejtësi përtej kufijve të origjinës.

Rritja e kërcënimeve ushtarake pasqyrohet: në tensionimin e situatës në zonat e krizës, duke çuar në konflikte të armatosura; nxitjen e garës së armatimeve; demonstrimin e fuqisë dhe shprehjen e interesave të aktorëve të caktuar; rishpërndarjen globale të fuqisë për të kontrolluar burimet; përdorimin e forcave të armatosura për të mbrojtur anëtarë dhe grupe nacionaliste në shtete të tjera; rishpërndarjen e ndikimit gjeostrategjik të aktorëve të rëndësishëm të komunitetit ndërkombëtar; kërcënimin në rritje për shmangien nga marrëveshjet për kufizimin e forcave konvencionale dhe armatimit bërthamor.

Në të ardhmen, mjedisi i sigurisë ndërkombëtare do të shfaqë jo vetëm kërcënimet tradicionale ushtarake, por edhe ato jokonvencionale.

Globalizimi, nga njëra anë, ka mundësuar lëvizjen e shpejtë dhe pa pengesa të njerëzve, mallrave, shërbimeve, informacionit, teknologjisë, ideve, por, nga ana tjetër, ka nxitur dhe ka përshpejtuar përhapjen e dukurive të kriminalitetit, trafikimit të armëve dhe terrorizmit. Sulmet kibernetike dhe përhapja e armëve të dëmtimit në masë përbëjnë një ndër kërcënimet kryesore ndaj sigurisë globale. Migrimi dhe fluksi i emigrantëve do të vazhdojë të përbëjë një sfidë serioze dhe humanitare për situatën e sigurisë globale.

Ndryshimet klimatike, mungesa e mundësive ekonomike në vendet e Lindjes së Mesme, Afrikës dhe Azisë Jugore, shtetet e dështuara, konfliktet e vazhdueshme rajonale, shpërndarja e pabarabartë e pasurisë, e cila ka thelluar diferencën ndërmjet shtresave sociale, do të jenë burim i migrimit drejt vendeve të zhvilluara.

Rrjetet kriminale dhe organizatat terroriste do të vazhdojnë të shfrytëzojnë fluksin e emigrantëve dhe azilkërkuesve, në interes të përfitimeve financiare dhe projektimit të sulmeve terroriste në vendet e destinacionit, duke rritur kërcënimet në mjedisin global të sigurisë.

Shqipëria është një vend që ka mbështetur dhe vazhdon të mbështesë çdo përpjekje ndërkombëtare në favor të paqes dhe sigurisë globale. Për më tepër, vendi ynë ndjek një politikë konstruktive rajonale, të mbështetur në parimet e bashkëpunimit drejt proceseve integruese euroatlantike, fqinjësisë së mirë dhe respektimit të të drejtave të pakicave, çka e bën Shqipërinë një vend me faktor të ulët rrisht për t'u përfshirë në konflikte globale, rajonale apo të brendshme.

2.2 Mjedisi rajonal i sigurisë

Kërcënimet jokonvencionale dhe transnacionale të sigurisë, që shqetësojnë sot vendet e rajonit, janë ato të lidhura me terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, krimin e organizuar, lëvizjet ekstremiste, trafikimin ilegal dhe sulmet kibernetike.

Ky mjedis dinamik nxit ndjeshëm kërcënimet dhe rreziqet, të cilat do të vijnë në ndikim në situatën e sigurisë rajonale. Rajoni i Ballkanit është në rrugën e integritit euroatlantik, pavarësisht problematikave komplekse politike, nacionaliste, tensioneve etnike dhe ekzistencës së dukurive të tilla si: ekstremizmi, radikalizmi, korrupsioni, krimi i organizuar, të cilat përbëjnë shkak për destabilitet.

Pozicioni gjeografik i rajonit të Ballkanit Perëndimor është përdorur si rrugëkalim drejt Evropës për emigrantët e paligjshëm, narkotikët, armët, municionet dhe lëndët plasëse, duke u vënë në fokus të grupeve e organizatave kriminale, terroriste, ekstremiste, brenda apo jashtë rajonit.

Krimi i organizuar rajonal, interesat e aktorëve të ndryshëm, radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm rrezikojnë qëndrueshmërinë e rajonit, duke e përdorur atë si bazë logjistike për realizimin e objektivave të tyre drejt Evropës.

Rajoni po përballë me sfida edhe si rezultat i shtrirjes së ndikimit të jashtëm dhe gjeopolitikës së aktorëve shtetërorë me interesa rajonale dhe globale, të cilët, duke shfrytëzuar mbështetjen dhe marrëdhëniet e ngushta historike me shtete të caktuara të rajonit, duan të pengojnë ecurinë e integritit euroatlantik të rajonit.

Sulmet kibernetike, degradimi mjedisor dhe fatkeqësitë natyrore përbëjnë një sfidë serioze për sigurinë rajonale, me pasoja dhe kosto të larta.

Shtetet e rajonit të Ballkanit Perëndimor janë të orientuara drejt vlerave dhe aspiratave evropiane dhe euroatlantike, pavarësisht dinamikës së brendshme komplekse politike dhe nacionaliste. Ato janë të angazhuara në garantimin e të drejtave të grupeve të ndryshme etnike dhe pakicave fetare, por mungesa e zhvillimit social-ekonomik, polarizimi politik, rritja e ndjenjave nacionaliste dhe mungesa e besimit të ndërsjellë mund të nxisin tensione dhe dhunë ndëretnike, me pasoja për rajonin dhe më gjerë.

2.3 Mjedisi i brendshëm i sigurisë

Mjedisi i brendshëm i sigurisë ndikohet nga mbështetja dhe përpjekjet që bën vendi ynë, në favor të paqes dhe sigurisë rajonale dhe globale, pozicioni gjeografik, situata jo e qëndrueshme politike në Ballkanin Perëndimor, si dhe nga afërsia me zonat e krizës (Lindja e Mesme, Afrika e Veriut).

Republika e Shqipërisë ndjek një politikë konstruktive, të bazuar në parimet e bashkëpunimit rajonal dhe mbështet fuqishëm proceset integruese euroatlantike, fqinjësinë e mirë dhe respektimin e të drejtave të pakicave kombëtare, politika të cilat e minimizojnë rrezikun për t'u përfshirë në konflikte të brendshme, rajonale dhe globale.

Si vend anëtar i NATO-s dhe kontribues për paqen e sigurinë globale, Republika e Shqipërisë është e ekspozuar ndaj terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm, kërcënimit konvencional, kibernetik dhe hibrid, të cilat, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, kërcënojnë sigurinë kombëtare.

Pozita gjeografike e ekspozon vendin tonë ndaj dukurive të transitit të narkotrafikantëve me origjinë nga Azia dhe e vendos atë afër rreziqeve që burojnë nga destabiliteti në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut. Transferimi i konflikteve politike, veçanërisht i atyre me bazë fetare etnike, trafiqet dhe emigracioni i paligjshëm mbeten sfida të rëndësishme për sigurinë e vendit.

Në të ardhmen, Shqipëria do të vijojë të jetë e ekspozuar ndaj kërcënimeve tradicionale ushtarake, formave të tjera të kërcënimeve terroriste, kërcënimeve kibernetike, luftës hibride, emigrimit të paligjshëm, krimin të organizuar dhe aktiviteteve të shërbimeve të huaja të inteligjencës.

Ekstremizmi i dhunshëm me frymëzim ideologjik, fetar dhe nacionalist do të vazhdojë të jetë sfidë dhe kërcënim konstant për sigurinë kombëtare. Zhvillimet jo të mjaftueshme social-ekonomike, varfëria, mungesa e arsimimit në shtresa të caktuara të shoqërisë krijojnë terren për zhvillimin e kësaj dukurie.

Reformat e ndërmarra në forcimin e shtetit ligjor dhe institucioneve demokratike, ristrukturimi dhe modernizimi i FARSH-ve, rritja e rolit të kontrollit civil demokratik mbi Forcat e Armatosura, zhvillimi i mëtejshëm i ekonomisë dhe standardeve të jetesës, respektimi i lirive

themelore dhe i të drejtave të njeriut, pjesëmarrja aktive dhe rritja e bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare, do të bëjnë që mjedisi i sigurisë kombëtare të forcohet dhe të garantojë paqe, stabilitet dhe zhvillim të qëndrueshëm për Republikën e Shqipërisë.

2.4 Kërcënimet dhe rreziqet e sigurisë

Mjedisi aktual i sigurisë përballet me një sërë kërcënimesh të mundshme, të cilat, në një kohë shumë të shkurtër dhe pa paralajmërim, mund të kthehen në rreziqe dhe kërcënime reale ndaj zonës euroatlantike, rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe vendit tonë. Identifikimi, njohja dhe vlerësimi i këtyre kërcënimeve dhe marrja e masave për përballimin e tyre do të ndikojë pozitivisht në menaxhimin e situatës së sigurisë në vendin tonë.

Këto kërcënime përfshijnë kërcënimin konvencional, terrorizmin, ekstremizmin, emigracionin e paligjshëm, përhapjen e armëve të dëmtimit në masë, krimin e organizuar, fatkeqësitë natyrore, kërcënimet kibernetike, luftën hibride dhe kërcënimin ndaj infrastrukturës kritike kombëtare.

2.4.1 Kërcënimi konvencional

Kërcënimi konvencional përbën një kërcënim të vazhdueshëm për vendin tonë, për shkak të pozicionit gjeostrategjik, të kaluarës historike dhe anëtarësisë në NATO, që mund të gjejë mbështetje nga aktorë shtetërorë.

2.4.2 Terrorizmi

Shqipëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të mundshëm të sulmeve terroriste, si rezultat i pjesëmarrjes dhe angazhimit në strukturat rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë dhe kontributit për paqen dhe sigurinë globale.

Kërcënimi më i mundshëm terrorist, me të cilin përballet Shqipëria, vjen nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm me frymëzim ideologjik, fetar apo nationalist. Zhvillimet në disa shtete në konflikt, në afërsi gjeografike me vendin tonë, janë burim i mundshëm frymëzimi, rekrutimi dhe indoktrinimi i individëve, me qëllim planifikimin dhe ekzekutimin e veprimtarive ekstremiste-terroriste jashtë këtyre zonave. Përdorimi i mediave sociale lehtëson komunikimin, propagandën dhe përhapjen e këtij fenomeni.

2.4.3 Emigracioni

Ndryshimet klimatike dhe demografike mund të çojnë në rritjen globale të varfërisë, urisë, emigracionit të paligjshëm dhe përhapjes së sëmundjeve pandemike. Republika e Shqipërisë, nisur nga pozicioni gjeografik, mund të shërbejë si vend transit dhe mund të preket nga një fluks i konsiderueshëm migrantësh me origjinë nga vendet në konflikt dhe të pastabilizuara. Kjo dukuri kërcënon sigurinë e vendit tonë, rrit mundësinë e projektimit të dukurive të terrorizmit dhe kërkon angazhim të madh të burimeve kombëtare dhe strukturave të sigurisë.

2.4.4 Përhapja e Armëve të Dëmtimit në Masë

Përhapja e Armëve të Dëmtimit në Masë (ADM) dhe të teknologjive të tyre përbën një nga shqetësimet më serioze për sigurinë. Qëllimi i grupeve terroriste për zotërimin dhe përdorimin e tyre i bën ato një rrezik potencial ndaj sigurisë globale, rajonale dhe lokale, me pasoja të paimagjinueshme.

Grupe terroriste janë të interesuara për aksesin në materialet bazë të Armëve të Dëmtimit në Masë (ADM), me qëllim prodhimin e tyre.

Zgjerimi i kapaciteteve të ADM-ve në vende të ndryshme si: Irani, Koreja e Veriut dhe Siria mund të përbëjnë një rrezik serioz, duke prishur balancat rajonale dhe globale. Kjo mund të gjenerojë gara të reja për armatime nga shtete të ndryshme, të cilat janë jomiqësore ndaj NATO-s dhe rrjedhimisht edhe ndaj Shqipërisë.

2.4.5 Kërcënimi kibernetik

Operacionet kibernetike konsiderohen një nga kërcënimet kryesore në hapësirën kibernetike të NATO-s dhe shteteve anëtare. Këto operacione, ka gjasa të përdoren nga aktorë shtetërorë, grupe të ndryshme apo edhe individë, për të grumbulluar informacion në fushën politike, ekonomike, shkencore dhe teknike, si dhe duke i përdorur këto mënyra të reja si mjete politike për të ndikuar mbi kundërshtarët e tyre. Zhvillimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit ekspozon Shqipërinë ndaj këtij kërcënimi, si dhe rrit mundësinë e sulmeve kibernetike.

2.4.6 Kërcënimi ndaj linjave të komunikimit dhe furnizimeve energjetike (infrastrukturës kritike kombëtare)

Republika e Shqipërisë, pavarësisht burimeve të veta energjetike hidrike, është e varur edhe nga sistemet dhe rrjetet ndërkombëtare të furnizimit. Ndërprerja e linjave jetësore të burimeve apo goditja ndaj infrastrukturës kritike kombëtare mund të ndikojë në interesat e sigurisë së Republikës së Shqipërisë.

Angazhimi i Shqipërisë dhe bërja pjesë në projektet evropiane të transportit të gazit natyror do të rrisë mundësinë e kërcënimeve të energjisë.

2.4.7 Lufta hibride

Aktorë shtetërorë dhe joshtetërorë në mjedisin e sotëm të sigurisë po përdorin luftën hibride për shtrirjen e ndikimit për arritjen e synimeve të tyre. Shqipëria, si vend anëtar i NATO-s, kërcënohet nga operacionet hibride, të cilat kanë si qëllim destabilizimin e funksionimit të shtetit dhe polarizimin e shoqërisë. Operacionet disinformuese, së bashku me mjete të tjera të tilla si përdorimi i medias për propagandë, mund të synojnë arritjen e epërsisë në fushën e informacionit dhe përhapjen e ndikimit.

2.4.8 Fatkeqësitë natyrore dhe epidemitë

Dukuritë natyrore të mundshme, si: tërmetet, përmbytjet, bllokimet nga dëborat, zjarret masive, rrëshqitjet e tokës dhe epidemitë e ndryshme përbëjnë rrezik për sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë.

Fatkeqësitë mund të vijnë edhe nga veprimtaria njerëzore, siç janë: aksidentet industriale, tokësore, ajrore, detare, por edhe si pasojë e veprimeve kriminale, terroriste etj. Ndotja e mjedisit, kufizimi i burimeve, rreziqet për shëndetin, ndryshimet e klimës, shpërdorimi, ndotja dhe mungesa e burimeve ujore përbëjnë rrezik për sigurinë e Republikës së Shqipërisë.

KREU III

INTERESAT DHE OBJEKTIVAT KOMBËTARË TË SIGURISË DHE TË MBROJTJES SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Interesat kombëtarë të Sigurisë së Republikës së Shqipërisë, zhvilluar në përputhje me Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, kanë për qëllim të sigurojnë kapacitetet dhe aftësitë mbrojtëse të vendit, brenda sistemit të mbrojtjes kolektive. Rritja e kapaciteteve të mbrojtjes dhe marrja e një pjese të arsyeshme dhe proporcionale e barrës së mbrojtjes kolektive përbëjnë një nga sfidat më të rëndësishme të politikës tonë të mbrojtjes.

3.1 Interesat kombëtarë

3.1.1 Interesat kombëtarë me rëndësi jetike

Interesat kombëtarë me rëndësi jetike të Republikës së Shqipërisë janë:

- a) ruajtja e pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit tonë;
- b) ruajtja e identitetit kombëtar.

3.1.2 Interesat strategjikë

Interesat strategjikë të Republikës së Shqipërisë, janë:

- a) mbrojtja dhe konsolidimi i rendit kushtetues demokratik;
- b) respektimi dhe zhvillimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;
- c) rritja e mirëqenies së popullit dhe zhvillimi gjithëpërfshirës i shoqërisë;
- ç) konsolidimi dhe forcimi i sundimit të ligjit;
- d) forcimi i institucioneve publike dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik;
- dh) mbrojtja e jetës, shëndetit dhe sigurisë personale të qytetarëve;
- e) mbrojtja e pronës publike, shtetërore dhe private;
- ë) forcimi i kohezionit shoqëror;
- f) ruajtja dhe promovimi i harmonisë fetare dhe respektimi i pakicave;
- g) përshpejtimi i procesit të integritetit në Bashkimin Evropian;
- gj) mbrojtja e të drejtave dhe mbështetja e prosperitetit të shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit;
- h) ruajtja dhe forcimi i paqes, stabilitetit dhe mirëqenies në rajonin tonë;
- i) forcimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit, mirëkuptimit, sigurisë bashkëpunuese dhe fqinjësisë së mirë dhe integrimi i rajonit në strukturat evropiane dhe euroatlantike;
- j) forcimi i rolit rajonal dhe ndërkombëtar të Shqipërisë;
- k) ruajtja e mjedisit dhe burimeve natyrore të Republikës së Shqipërisë.

3.1.3 Objektivat themelorë të sigurisë kombëtare, janë:

a) realizimi i një niveli të lartë sigurie, me qëllim parandalimin në kohë të kërcënimeve dhe rreziqeve të sigurisë, nëpërmjet organizimit, nivelit të lartë të trajnimit dhe zhvillimit të të gjitha kapaciteteve të kërkuara për zbulimin, në kohën e duhur, të kërcënimeve dhe rreziqeve, si dhe realizimin e përgjigjes efikase ndaj tyre;

b) ruajtja e paqes dhe forcimi i sigurisë dhe stabilitetit në rajon e më gjerë.

Republika e Shqipërisë ndjek interesat e saj jetikë dhe strategjikë në mënyrë të pavarur, nëpërmjet bashkëpunimit intensiv dypalësh dhe shumëpalësh, rolit aktiv në rajon dhe pjesëmarrjes në organizatat e sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare.

3.2 Interesat dhe objektivat e mbrojtjes

Qëllimi i politikave të mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë është vlerësimi i interesave themelorë të mbrojtjes, si dhe i kërcënimeve e rreziqeve ndaj sigurisë kombëtare, të cilat kërkojnë përgjigje efikase të sistemit të mbrojtjes dhe përdorim, në mënyrë optimale, të burimeve të mbrojtjes, për përmbushjen e objektivave në fushën e mbrojtjes.

3.2.1 Interesat themelorë të mbrojtjes

Interesat themelorë në fushën e mbrojtjes janë:

a) ruajtja e pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit tonë;

b) krijimi dhe mbajtja në nivelin e duhur të kapaciteteve mbrojtëse të vendit dhe gatishmërisë së tyre;

c) përmbushja e interesave të mbrojtjes së përbashkët dhe detyrimeve ndërkombëtare të vendit, në kuadër të NATO-s, OKB-së dhe Bashkimit Evropian dhe organizatave ku vendi ynë është anëtar dhe ka detyrime.

ç) forcimi i bashkëpunimit rajonal për krijimin e kushteve, në mbështetje të paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë.

3.2.2 Objektivat e mbrojtjes

Objektivat e mbrojtjes janë:

a) mbrojtja e pavarësisë, paprekshmërisë dhe integritetit territorial të vendit, nëpërmjet parandalimit efikas të kërcënimeve ushtarake dhe kërcënimeve asimetrike;

b) zhvillimi i kapaciteteve dhe aftësive mbrojtëse të vendit;

c) funksionimi i vazhdueshëm i sistemit të mbrojtjes dhe sistemeve të tjera të mbështetjes sociale;

ç) forcimi i bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh në fushat e sigurisë dhe mbrojtjes;

d) pjesëmarrja në përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për të ruajtur paqen dhe forcuar sigurinë dhe stabilitetin në rajon dhe më gjerë;

dh) rritja e ndërgjegjësimit të shoqërisë për rëndësinë e sistemit kombëtar të mbrojtjes dhe forcimi i mbështetjes nga ana e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, të sistemit tonë të mbrojtjes;

e) përmbushja e Nivelit të Ambicies (NiA) së Republikës së Shqipërisë brenda dhe jashtë vendit.

ë) ruajtja e nivelit të gatishmërisë së kapaciteteve të mbrojtjes për të kryer të gjitha detyrat themelore të mbrojtjes, të cilat nuk duhet të reduktohen nën minimumin e standardeve të krahasueshme ushtarake ndërkombëtare dhe niveleve të pranueshme të rrezikut.

KREU IV

SISTEMI I MBROJTJES I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Sistemi i mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë është pjesë e sistemit të sigurisë kombëtare, i cili ka për detyrë realizimin e objektivave kombëtarë në fushën e mbrojtjes.

Qëllimi i sistemit të mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë është të sigurojë kapacitete dhe aftësi mbrojtëse të vendit, për të realizuar interesat kombëtarë dhe për të përmbushur objektivat në fushën e mbrojtjes. Baza themelore e kapaciteteve të sistemit të mbrojtjes qëndron tek aftësia e tij për të siguruar mbrojtjen e vendit.

Sistemi i mbrojtjes përbëhet nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si zotëruese e kapaciteteve kryesore të mbrojtjes dhe nga institucionet/strukturat e tjera shtetërore,

të cilat hartojnë dhe zbatojnë politikën e mbrojtjes, sigurojnë kushtet për funksionimin e të gjithë sistemit të mbrojtjes, ofrojnë kapacitete civile, në mbështetje të Forcave të Armatosura dhe forcave aleate, si dhe zbatojnë masa për mbrojtjen e vendit dhe funksionimin e sistemit të mbrojtjes në situata krize. Organizatat joqeveritare, shoqëria civile dhe media, përfshihen në sistemin e mbrojtjes nëpërmjet realizimit të veprimtarive të tyre të cilat i kontribuojnë mbrojtjes së vendit.

4.1 Misioni dhe roli i Forcave të Armatosura

Misioni, detyrat themelore dhe veprimtaria e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) rregullohen me aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, duke filluar me Kushtetutën e RSH-së, e cila, në nenin 12 të saj, sanksionon se: “Forcat e Armatosura sigurojnë pavarësinë e vendit, si dhe mbrojnë tërësinë territoriale dhe rendin e tij kushtetues”.

Në zbatim të këtij detyrimi kushtetues, FARSH-të dhe strukturat e tjera të shtetit përgatiten dhe angazhohen për ruajtjen e pavarësisë, sovranitetit dhe tërësisë territoriale të vendit, në bashkëveprim me forcat aleate, mbrojtjen dhe mbështetjen e popullsisë në kohë paqeje, krize e lufte, kontributin për mbrojtjen kolektive, si dhe paqen dhe sigurinë në rajon e më gjerë.

Detyrat thelbësore të FARSH-ve për realizimin e misionit janë: përgatitja, rritja e gatishmërisë operacionale, aktivizimi i forcave, kryerja e detyrave operacionale.

Kontributi i FARSH-ve për paqen, sigurinë dhe stabilitetin ndërkombëtar përfshin mbështetjen për diplomacinë, pjesëmarrjen në promovimin e sigurisë dhe besimit reciprok, kryerjen e detyrave të veçanta në lidhje me kontrollin dhe mospërhapjen e Armëve të Shkatërrimit në Masë, pjesëmarrjen në operacionet e reagimit ndaj krizave, si dhe në operacionet kundër terrorizmit dhe kërcënimeve të tjera ndaj paqes.

FARSH-të kanë hapësirën e plotë kushtetuese për t’u përgatitur dhe për t’u angazhuar në të gjithë skenarët strategjikë të sigurisë, si në rolin kryesor, ashtu edhe në atë mbështetës apo kontribues. Përdorimi i fuqisë ushtarake do të realizohet sipas rastit, në kohë paqeje, krize dhe lufte. Në këtë kontekst, FARSH-të përgatiten dhe angazhohen për arritjen e shtatë objektivave kryesorë ushtarakë.

4.2 Objektivat kryesorë të sistemit të mbrojtjes

Objektivi 1: Sigurimi i kapaciteteve dhe aftësive të nevojshme të mbrojtjes për ruajtjen e pavarësisë, sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Republikës së Shqipërisë.

Ky objektivi ka për synim garantimin e pavarësisë, sovranitetit dhe mbrojtjes së territorit të vendit nga një agresion i mundshëm nga jashtë, në të cilin FARSH-të kanë rolin kryesor. Në rast të agresionit ushtarak, FARSH-të, në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me aleatët e saj, në kuadrin e mbrojtjes kolektive, realizojnë mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë me objektivi për t’i rezistuar e për të penguar armikun dhe për të rivendosur sovranitetin kombëtar, në të gjithë territorin e RSH-së, nëse ai cenohet.

FARSH-të koordinojnë skenarët e planëzimit të mbrojtjes me Planet e Mbrojtjes së Krahut Jugor të Aleancës, në bashkëpunim me vendet anëtare, bazuar në artikullin 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut. Rritja e kapaciteteve të mbrojtjes, të nevojshme në rast të përkeqësimit të gjendjes së sigurisë, duhet të paraprihet nga krijimi i mekanizmave dhe të kushteve bazë, për të siguruar pritjen e forcave të NATO-s, si dhe mobilizimin, kompletimin, trajnimin dhe përdorimin e Forcës Rezerviste.

Shqipëria zhvillon kapacitetet e mbrojtjes kombëtare me prioritet objektivat e kapaciteteve, si detyrime të mbrojtjes kolektive, në kuadër të Traktatit të Atlantikut të Veriut.

Objektivi 2. Mbështetja e institucioneve të sigurisë dhe ruajtjes së rendit kushtetues.

FARSH-të do të marrin pjesë në operacione në mbështetje të ruajtjes së rendit kushtetues, duke zhvilluar kapacitete në përgjigje të kërcënimeve dhe rreziqeve jokonvencionale. Pjesëmarrja e FARSH-ve në këto lloj operacionesh bëhet në përputhje me autoritetin që u jep ligji dhe në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, kur forcat e rendit dhe të sigurisë nuk kanë kapacitete të mjaftueshme dhe/ose nuk disponojnë kapacitete të veçanta për përballimin e situatës.

Objektivi 3. Rritja e nivelit të gatishmërisë dhe operacionalitetit të FARSH-ve.

Masat për rritjen e nivelit të gatishmërisë dhe qëndrueshmërisë së FARSH-ve do të përqendrohen kryesisht në përmirësimin e treguesve të operacionalitetit: personel, pajisje, stërvitje dhe resurse.

Përmirësimi i treguesve të operacionalitetit do të synojë rritjen e gatishmërisë për dislokimin dhe angazhimin e forcave. Forcimi i vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës i nivelit të gatishmërisë, ndërveprueshmërisë dhe reagimit të FARSH-ve ndikon drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë e sistemit të mbrojtjes.

Pjesëmarrja e FARSH-ve në stërvitjet e NATO-s do të rrisë aftësitë e tyre për të vepruar në operacione dhe për të mbështetur zbatimin e Planit të Veprimit për gatishmërinë e NATO-s. Kapacitetet për dislokueshmëri, lëvizshmëri dhe vetëmbështetje përbëjnë disa nga elementët më të rëndësishëm të sigurimit të qëndrueshmërisë të FARSH-ve.

Sigurimi i burimeve të mjaftueshme financiare për kompletimin me armatim, pajisje dhe aktive të domosdoshme për stërvitje dhe operacione, si dhe balancimi i kapaciteteve me burimet, përbën një nga sfidat më të rëndësishme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-ve.

Objektivi 4: Zhvillimi i kapaciteteve dhe pjesëmarrja në operacionet e drejtuara nga NATO-ja, në kuadrin e nenit 5 dhe jashtë nenit 5.

Operacionet luftarake të nenit 5 planëzohen dhe drejtohen në kuadër të mbrojtjes kolektive të Aleancës për mbrojtjen e territoreve të vendeve aleate. Operacionet e mbrojtjes kolektive ose të nenit 5 ndahen në operacione me intensitet të lartë dhe në operacione me intensitet të ulët. Operacionet e mbrojtjes kolektive me intensitet të lartë janë operacione për mbijetesën e Aleancës dhe të aleatëve të saj.

Këto lloj operacionesh mund të kryhen për shkatërrimin ose paaftësimin e kundërshtarëve apo aleancave që tentojnë të jenë të krahasueshme me fuqinë luftarake të NATO-s. Operacionet e mbrojtjes kolektive me intensitet të ulët janë operacione që mund të kryhen për shkatërrimin ose paaftësimin e forcave të kundërshtarëve, të cilat nuk janë të krahasueshme me fuqinë luftarake të NATO-s.

Operacionet jashtë nenit 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut janë operacione në përgjigje të rreziqeve e kërcënimeve jokonvencionale, të cilët mund të zhvillohen si brenda, ashtu edhe jashtë territorit të Aleancës. Këto lloj operacionesh karakterizohen nga pjesëmarrja e gjerë e shumë agjencive, organizatave qeveritare dhe joqeveritare, si dhe mjeteve, forcave dhe kapaciteteve civile.

Zhvillimi i objektivave të kapaciteteve dhe aftësive tona të mbrojtjes do të kontribuojnë në mbrojtjen e përbashkët dhe sigurinë e territoreve, popullatës dhe vlerave të vendeve anëtare të Organizatës së Atlantikut të Veriut, në përputhje me Konceptin Strategjik të NATO-s, veçanërisht të detyrave themelore: mbrojtjes kolektive, menaxhimit të krizave dhe sigurisë bashkëpunuese.

Objektivi 5. Zhvillimi i kapaciteteve për pjesëmarrje dhe mbështetje të paqes dhe sigurisë rajonale dhe globale.

Ky objektivi lidhet me angazhimin e FARSH-ve në përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë rajonale dhe globale. Për përmbushjen e këtij objektivi, FARSH-të përgatiten për të kontribuar me kapacitetet përkatëse në misionet për menaxhimin e krizave dhe ato të mbështetjes së paqes.

FARSH do të angazhojnë kapacitete për pjesëmarrje edhe në veprimtari të tjera joluftarake, siç janë: asistencë trajnuese dhe këshilluese, reforma në sektorin e sigurisë, zhvillimi i kapaciteteve në fushën e mbrojtjes, zhvillimi i programeve të bashkëpunimit ushtarak etj.

Republika e Shqipërisë do të vijojë të kontribuojë me kapacitete kombëtare, për të mbështetur zbatimin e Strategjisë Globale të BE-së për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë, në interesin e përbashkët të garantimit të paqes, sigurisë, prosperitetit, demokracisë dhe një rendi botëror, të bazuar te demokracia funksionale dhe shteti i së drejtës.

Objektivi 6: Zhvillimi i kapaciteteve operacionale të FARSH-ve, në përgjigje të emergjencave civile.

Operacionet e ndërhyrjes në emergjencat civile zhvillohen në koordinim dhe bashkëveprim me të gjithë aktorët që veprojnë në RSH, si dhe ekipet e vendeve të tjera, në kuadër të NATO-s apo marrëveshjeve dypalëshe.

FARSH-të do të zhvillojnë kapacitetet e duhura në mjete, pajisje dhe personel të trajnuar për përballimin, ndërhyrjen dhe kryerjen e operacioneve të emergjencave civile, për të garantuar jetën e njerëzve, për të minimizuar humbjet materiale, dëmtimet e pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit.

Objektivi 7: Rritja e qëndrueshmërisë dhe aftësisë reaguese të shtetit dhe shoqërisë ndaj kërcënimeve të mundshme të sigurisë.

Shteti dhe shoqëria shqiptare do të përgatiten për të përballuar me efikasitet kërcënimet e sotme dhe të ardhshme të sigurisë, me vëmendje të veçantë funksionimin e vazhdueshëm të qeverisjes në të gjitha nivelet, sigurinë njerëzore; vazhdimësinë e shërbimeve publike dhe funksionimin e infrastrukturës; sigurimin e furnizimit me ushqim, energji elektrike dhe ujë; ruajtjen dhe sigurimin e informacionit, komunikimit dhe burimeve të tjera të rëndësishme për funksionimin e shtetit; mbrojtjen e infrastrukturës kritike, përfshirë sigurinë kibernetike; sigurinë e pronës shtetërore dhe private; përmirësimin e mekanizmave kundër kërcënimeve të luftës hibride etj.

Monitorimi i vazhdueshëm i situatës, përmirësimi i masave të reagimit ndaj krizave dhe koordinimi i tyre në planet përkatëse kanë rëndësi të veçantë për t'iu përgjigjur në kohë dhe me efikasitet kërcënimeve të mundshme të sigurisë, duke përcaktuar në detaje detyrat dhe përgjegjësitë e FARSH-ve.

Sistemi i menaxhimit të krizave dhe aftësia e shtetit për t'iu përgjigjur kërcënimeve të ndryshme të sigurisë, të testohen periodikisht nëpërmjet stërviçeve të menaxhimit të krizave në nivel kombëtar, përfshirë edhe vendimmarrësit e nivelit më të lartë politik-strategjik. Gjatë kohës së paqes, është e rëndësishme të rritet ndërgjegjësimi i popullsisë dhe shoqërisë civile për çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes, nëpërmjet hartimit dhe përmirësimit të bazës ligjore përkatëse.

4.3 Skenarët më të mundshëm të angazhimit të Forcave të Armatosura dhe strukturave të tjera të sigurisë kombëtare

Skenarët më të mundshëm të angazhimit të FARSH dhe strukturave të tjera të sigurisë kombëtare janë zhvilluar mbi bazën e analizës së thelluar të rreziqeve, kërcënimeve, sfidave dhe shanseve, si dhe të mjedisit të sigurisë. Spektri i tyre përfshin të gjitha kërcënimet e mundshme ndaj sigurisë së vendit tonë, të listuar si më poshtë:

- Skenarët ku Ministria e Mbrojtjes/Forcat e Armatosura kanë rolin parësor:

- Cenimi i integritetit territorial/sovrانيتetit;
- Pjesëmarrje në operacionet ndërkombëtare;
- Situata Emergjence Civile (EC);
- Kërcënime Kibernetike;
- Operacione të Kërkim-Shpëtimit;
- Situata "Renegade".

- Skenarët ku institucionet e tjera kanë rolin parësor:

- Cenimi i rendit kushtetues;
- Sulm terrorist (Ekstremizmi i dhunshëm dhe luftëtarët e huaj);
- Zhvendosje masive e njerëzve/refugjatëve/emigrantëve;
- Cenimi i ligjshmërisë në hapësirën detare.

Qasja analitike ku bazohen skenarët përfshin këto elemente: situata e përgjithshme, qëllimi strategjik, objektivat, vlerësimi i rrezikut, pritjet/supozimet, kufizimet e ndryshme, si dhe përshkrimi i situatave operacionale përkatëse. Mbi këtë bazë, përcaktohet misioni dhe koncepti operacional për çdo institucion pjesëmarrës.

Ndërtimi i skenarëve është bazuar te supozimet, të cilat përmbajnë: kontekstin e skenarit, misionin e FARSH, parashikimet për nivelin e kërcënimit, kufizimet, mjedisin operacional; kohën kur mund të ndodhë, afatin e paralajmërimit, mobilizimin dhe dislokimin e forcës; rregullat e angazhimit (ROE) dhe gjendjen përfundimtare të dëshiruar.

Përpunimi i skenarëve merr në konsideratë edhe faktorë të tjerë të mjedisit të sigurisë, si dhe detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në NATO dhe struktura të tjera të sigurisë ndërkombëtare, si: OKB-ja, BE-ja, OSBE-ja dhe koalicionet e tjera.

Për çdo skenar janë evidentuar kërkesat operacionale, të cilat janë shprehur në kapacitetet përkatëse operacionale. Forca e ardhshme balancon tërësinë e kapaciteteve të nevojshme, të evidentuara nga procesi i RSM-së, me burimet e disponueshme të mbrojtjes.

FARSH-të do të marrin pjesë edhe në skenarët e NATO-s.

4.3.1 Analiza e skenarëve dhe identifikimi i misioneve

Mbi bazën e spektrit të konfliktit dhe ndryshoreve të intensitetit të angazhimit të forcave të sigurisë, në kohë paqeje, krize, apo lufte, përcaktohen kapacitetet e nevojshme të FARSH-ve dhe ato të ministrive dhe strukturave të tjera të përfshira.

Përcaktimi i kapaciteteve për përballimin e skenarëve përfshin: misionin kryesor apo mbështetës në përballimin e skenarit, misionet dhe detyrat e çdo strukture pjesëmarrëse, një numër kushtesh për përmbushjen e detyrave (civile dhe ushtarake), si dhe kapacitetet që çdo institucion ofron.

Mundësia e ndodhjes së dy a më shumë skenarëve në të njëjtën kohë kanë shërbyer si bazë për përcaktimin e kapaciteteve të forcës së ardhshme.

4.3.2 Vlerësimi i skenarëve

FARSH-të mund të përfshihen në skenarë të mundshëm të operacioneve me intensitet të lartë dhe të ulët brenda vendit; në operacionet e mbrojtjes kolektive dhe në operacionet në përgjigje ndaj krizave, në kuadrin e NATO-s; në operacionet e emergjencave civile dhe në mbështetje të strukturave të tjera të sigurisë për mbrojtjen e rendit kushtetues.

Skenarët janë të natyrës gjithëpërfshirëse dhe parashikojnë pjesëmarrjen e strukturave ushtarake e civile. Ato parashikojnë edhe angazhimin për përballimin e kërcënimeve dhe rreziqeve hibride, si dhe sulmeve kibernetike.

Prirjet dhe natyra e kërcënimeve dhe rreziqeve kërkojnë menaxhim efikas dhe bashkëpunim midis aktorëve shtetërorë dhe joshetërorë, të mbështetur nga një infrastrukturë e plotë ligjore.

4.4 Niveli i Ambicies i Republikës së Shqipërisë

Niveli i Ambicies së FARSH-ve buron nga strategjitë dhe dokumentet e rëndësishme politike kombëtare, si dhe ato të NATO-s. Niveli i ambicies së FARSH-ve është i ndërthurur me kapacitetet e NATO-s, të cilat plotësojnë atë pjesë të kapaciteteve operacionale që vendi ynë nuk ka burime të mjaftueshme dhe mundësi për t'i zhvilluar.

Niveli i Ambicies së FARSH-ve përcakton kapacitetet e nevojshme ushtarake e civile për pjesëmarrje në operacione kombëtare dhe ndërkombëtare, më vete ose me aleatët. Ai duhet të sigurojë:

a) sovranitetin dhe integritetin e vendit deri në aktivizimin e burimeve të tjera kombëtare dhe/apo aktivizimin e nenit 5 të Aleancës;

b) pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë për mbrojtjen kolektive të territoreve të Aleancës. Kontributi i vendit tonë, sipas procesit të Planifikimit të Mbrojtjes të NATO-s, do të jetë një grupim taktik “grup-batalion i këmbësisë së lehtë”, me angazhim gjashtë muaj deri në një vit, pa rotacion, të konfiguruar sipas misionit;

c) pjesëmarrjen në operacionet në përgjigje ndaj krizave, e cila të realizohet sipas konceptit të “një grupimi të vetëm forcash” për NATO-n/BE-në/OKB-në apo koalicionet e mundshme. Niveli i kësaj Ambicieje të jetë deri në tre kompani njëherësh në operacione me rotacion të vijueshëm. Pjesëmarrja mund të bëhet edhe me kapacitete të veçanta “Niche”, si dhe ekspertë (civile dhe ushtarakë) trajnuar, këshillues, koordinatorë, vëzhgues etj., sipas sistemit të pikëzimit, të pranuar nga Aleanca;

ç) parandalimin, përballimin dhe lehtësimin e pasojave të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore apo veprimtaria njerëzore që mund të ndodhin në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke angazhuar kapacitetet operacionale, të deklaruara në Planin Kombëtar të Emergjencave Civile (EC). Detyrat, përgjegjësitë, burimet, marrëdhëniet e komandim-kontrollit dhe koordinimi i strukturave, që angazhohen në EC, do të përcaktohen në paketën ligjore përkatëse.

Numri i personelit të FARSH-ve do të jetë në vitin 2020: 8500 forca aktive dhe 2100 forca rezerviste (25% të forcave aktive).

4.5 Kapacitetet dhe aftësitë e mbrojtjes

Mbrojtja e Republikës së Shqipërisë bazohet në aftësitë mbrojtëse të vendit dhe ato të Aleancës, në kuadrin e sistemit të mbrojtjes kolektive. Elementet bazë të mbrojtjes së vendit janë:

- a) kapacitetet dhe aftësitë e mbrojtjes së vendit;
- b) përgatitja dhe qëndrueshmëria e FARSH-ve;
- c) garancitë e mbrojtjes dhe sigurisë nga NATO-ja.

Operacionet ushtarake të FARSH-ve për mbrojtjen e vendit do të bashkërendohen me planet përkatëse të operacioneve të Aleancës. Për këtë qëllim, FARSH-të planëzojnë, stërviten, pajisen dhe bashkërendojnë veprimtarinë e tyre me Shtabin e NATO-s, strukturat komanduese dhe strukturat e forcave të NATO-s, që në kohë paqeje.

4.5.1 Fushat e kapaciteteve operacionale

FARSH-të do të zhvillojnë kapacitetet e nevojshme operacionale, bazuar në vlerësimin e fushave të mëposhtme: doktrinë, organizim, trajnim, personel, materiale, lidhshmëri, infrastrukturë dhe ndërveprim.

Bazuar në analizën e kërkesave operacionale për përballimin e skenarëve të sipërpërmendur, si dhe në paketën e objektivave të kapaciteteve të NATO-s, FARSH-të do të zhvillojnë kapacitete të luftimit, të mbështetjes së luftimit, të mbështetjes me shërbime të luftimit, të kërkim-shpëtimit, për emergjencat civile, të arsimimit dhe stërvitjes, si dhe të komandim-kontrollit.

a) Kapacitetet e luftimit

Kapacitetet e luftimit shërbejnë për të kryer operacione luftarake dhe operacione në përgjigje të krizave. Këto kapacitete përfshijnë njësitë e luftimit, të cilat krijohen, organizohen, pajisen dhe stërviten për zhvillimin e operacioneve, për të siguruar sovranitetin dhe integritetin e vendit deri në aktivizimin e burimeve të tjera kombëtare dhe aktivizimin e nenit 5 të Aleancës. Bazën e kapaciteteve të luftimit e përbëjnë njësitë e luftimit të forcës tokësore (batalionet e luftimit), ndërsa ato të forcave të tjera do të zhvillohen në kohë të përshtatshme, në përputhje me nivelin e rrezikut ndaj sigurisë kombëtare dhe detyrimet ligjore.

b) Kapacitetet e mbështetjes së luftimit

Kapacitetet e mbështetjes së luftimit përfaqësojnë aftësitë e FARSH-ve për të mbështetur operacionet, në përmbushje të misionit dhe detyrave.

Ato përbëhen nga kapacitetet e mbështetjes me fuqi zjarri dhe kapacitetet që ofrojnë ndihmë operacionale të elementeve të luftimit, të tilla si kapacitetet e inteligjencës, sigurisë, mbrojtjes nga armët e dëmtimit në masë, xhenios luftuese dhe komandim-kontrollit e komunikimit.

c) Kapacitetet e mbështetjes me shërbime të luftimit

Kapacitetet e mbështetjes me shërbime të luftimit përfaqësojnë aftësitë e FARSH-ve për të mbështetur operacionet, në përmbushje të misionit dhe detyrave. Në këto kapacitete përfshihen kapacitetet e furnizimit, transportit, mirëmbajtjes, kujdesit shëndetësor, kujdesit psikologjik dhe të administrimit.

ç) Kapacitetet për përballimin e emergjencave civile

FARSH-të zotërojnë kapacitete operacionale për përballimin e emergjencave civile (EC). Këto kapacitete, si dhe kapacitetet e strukturave të tjera qendrore dhe lokale, integrohen dhe koordinohen, sipas Planit Kombëtar të EC.

d) Kapacitetet e kërkim-shpëtimit

Kapacitetet e kërkim-shpëtimit përfaqësojnë aftësitë e FARSH-ve për të realizuar operacionet e kërkim-shpëtimit në tokë, ajër dhe det. Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit koordinon operacionet e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë. Ajo, gjithashtu, bashkëvepron me strukturat homologe të shteteve të tjera.

dh) Kapacitetet e arsimimit dhe stërvitjes

Kapacitetet e arsimimit dhe stërvitjes përfaqësojnë aftësitë e FARSH-ve për të mbështetur arsimimin, edukimin, përgatitjen dhe trajnimin e personelit të FARSH-ve, në të gjitha nivelet.

e) Kapacitetet e komandim-kontrollit

Kapacitetet e komandim-kontrollit sigurojnë aftësitë për të ushtruar autoritetin dhe përgjegjësitë e drejtimit, për përmbushjen e misionit.

Zhvillimi i kapaciteteve të mësipërme duhet të garantojë ndërveprueshmërinë si ndërmjet komponentëve të FARSH-ve, ashtu edhe me strukturat e tjera të sigurisë në vend dhe me forcat e Aleancës.

4.5.2 Konceptet e përdorimit operacional të FARSH-it

A. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë

FARSH-të organizohen dhe funksionojnë si një strukturë e përbashkët, me përbërje: forcat tokësore, detare, ajrore dhe strukturat mbështetëse. Forcat tokësore, detare dhe ajrore përbëjnë komponentët operacionalë tokësorë, detarë dhe ajrorë për mbrojtjen e vendit. Përdorimi operacional i FA bëhet i bazuar në konceptin e formacioneve operacionale të organizuara për detyrë (task-force), të cilat ngrihen si një bashkim kapacitetesh ushtarake, në përputhje me natyrën e misionit që i ngarkohet.

B. Forca tokësore

Forca tokësore zhvillon, mban në gatishmëri dhe vë në dispozicion kapacitete të luftimit dhe të mbështetjes me luftim, për të kryer operacione tokësore në mbrojtje të sovranitetit të vendit dhe në përmbushje të detyrimeve në kuadër të Aleancës.

Forca tokësore kryen këto detyra kryesore:

1. stërvitjen e strukturave për të gjithë spektrin e operacioneve tokësore;
2. arritjen dhe mbajtjen e nivelit të kërkuar të operacionalitetit të strukturave të saj;
3. kryerjen e operacioneve luftarake tokësore për të mbrojtur integritetin territorial të vendit, në rast kërcënimesh të jashtme të karakterit ushtarak;
4. vënien në dispozicion të SHPFA-së të njërive të kërkuara për angazhim në operacione jashtë vendit;
5. angazhimin në operacionet e emergjencave civile dhe kërkim-shpëtimit;
6. përmbushjen e detyrimeve të objektivave të kapaciteteve për të marrë pjesë në operacionet në kuadër të mbrojtjes kolektive;
7. pjesëmarrjen në operacione për menaxhimin e krizave, të drejtuara nga NATO-ja, BE-ja, OKB-ja;
8. Bashkëpunimin me forcat e tjera dhe strukturat mbështetëse, sipas nevojës dhe fushës së përgjegjësisë.

C. Forca detare

Forca detare përgatit, mban në gatishmëri dhe vë në dispozicion kapacitete për mbrojtjen e integritetit territorial dhe sovranitetit të vendit, nëpërmjet pranisë në det dhe kryerjes së operacioneve të sigurisë detare.

Forca detare disponon kapacitete të rëndësishme në kryerjen e operacioneve, në funksion të misionit kushtetues të FARSH-ve, në funksion të rojës bregdetare, në kuadrin e Aleancës dhe mbështetjen e autoriteteve civile. Këto operacione kryhen më vete ose në bashkëpunim me strukturat e tjera të FARSH-ve, me institucionet e zbatimit të ligjit që kanë interesa në det, si dhe me aleatët.

Forca detare kryen këto detyra kryesore:

1. garantimin e sigurisë në hapësirën detare;
2. mbajtjen në gatishmëri dhe angazhimin e kapaciteteve në operacionet e kërkim-shpëtimit në hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë;
3. mbajtjen në gatishmëri dhe angazhimin e kapaciteteve për operacionet e emergjencave civile dhe kërkim-shpëtimit;
4. garantimin e sigurisë hidrolundrimore në bregdetin dhe hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë;
5. monitorimin e zbatueshmërisë së legjislacionit kombëtar dhe normave të së drejtës ndërkombëtare, të pranuar nga vendi ynë në hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë.

Ç. Forca ajrore

Forca ajrore përgatit, mban në gatishmëri dhe vë në dispozicion kapacitete për mbrojtjen e integritetit territorial dhe sovranitetit të vendit, për përmbushjen e detyrimeve kombëtare në kuadrin e Aleancës dhe mbështetjen e autoriteteve civile. Ajo krijon dhe mban në gatishmëri kapacitete operacionale të kërkuara në funksion të misionit kushtetues të FARSH-it.

Forca ajrore mbron sovranitetin e hapësirës ajrore të vendit, duke bashkëpunuar me agjencitë e koordinimit të hapësirës ajrore të NATO-s dhe Albkontroll-in, për vëzhgimin ajror dhe patrullimin e hapësirës ajrore të RSH-së.

Forca ajrore merr masa dhe koordinon veprimtarinë për zbatimin e projekteve të NATO-s për kthimin e bazës ajrore në Kuçovë në “NATO Tactical Air Base”.

Forca Ajrore kryen këto detyra kryesore:

1. monitorimin dhe kontrollin e hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe paralajmërimin në kohë të kërcënimit të saj, në bashkëpunim me strukturat e tjera të FARSH-ve dhe të NATO-s;

2. mbështetjen me shërbim meteorologjik të FARSH-ve dhe institucioneve të tjera shtetërore;

3. reagimin, në bashkëveprim me NATO-n, ndaj shkeljeve të hapësirës ajrore;

4. sigurimin me mbulim ajror, në bashkëveprim me NATO-n, të objekteve të rëndësishme të veçantë, bazuar në implementimin e sistemit NATINAMDS;

5. mbajtjen në gatishmëri dhe angazhimin e kapaciteteve për operacionet e emergjencave civile dhe kërkim-shpëtimit.

D. Strukturat mbështetëse

Struktura bazë e mbështetjes e FARSH-ve është Komanda Mbështetëse. Ajo zhvillon kapacitetet e duhura për të siguruar mbështetje logjistike, infrastrukturore, xheniere, shëndetësore dhe shërbime të tjera, në interes të plotësimit të misionit dhe detyrave të FARSH-ve. Ajo zhvillon dhe angazhon kapacitete të mbështetjes me shërbime për kryerjen e operacioneve ushtarake, emergjencave civile, kërkim-shpëtimit dhe në ndihmë të komunitetit.

4.5.3 Forcimi i kapaciteteve të mbrojtjes

Përprjekjet për të përmirësuar kapacitetet e mbrojtjes së vendit të orientohen drejt:

a) zhvillimit të aftësive luftarake;

b) sigurimit të kushteve të nevojshme për ngritjen e nivelit të gatishmërisë luftarake dhe qëndrueshmërisë së FARSH-ve;

c) rritjes së burimeve të mbrojtjes dhe përdorimit me efikasitet të tyre, në funksion të modernizimit të FARSH-ve;

ç) përmirësimit të sistemit për mobilizimin kombëtar të forcave të mbrojtjes, në rast të një kërcënimi të drejtpërdrejtë ushtarak ndaj vendit;

d) rritjes së qëndrueshmërisë së shtetit ndaj kërcënimeve bashkëkohore dhe të ardhshme të sigurisë.

KREU V

ZHVILLIMI I BURIMEVE TË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Zhvillimi i burimeve të mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë është një çështje e rëndësishme për transformimin dhe modernizimin e FA-së për periudhën 2019–2025. Elementet kryesore të burimeve të mbrojtjes janë: burimet njerëzore, materiale dhe financiare. Burimet e mbrojtjes mundësojnë realizimin e misionit dhe detyrave themelore të FARSH-ve.

5.1 Burimet njerëzore

Burimet njerëzore janë një ndër elementët kryesorë të burimeve të mbrojtjes. Zhvillimi i tyre përfshin të gjitha fazat e ciklit jetësor të personelit: rekrutimin, arsimimin, trajnimin, caktimin në detyrë, promovimin në gradë dhe karrierë, daljen në rezervë dhe në pension. Menaxhimi i burimeve njerëzore realizohet nga ministri i Mbrojtjes, shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe komandantët e komandave kryesore të FARSH-ve dhe synon zbatimin e një procesi transparent, të besueshëm dhe me efektivitet të plotë.

Personeli i Ministrisë së Mbrojtjes dhe FARSH-të do të përbëhet nga 8900 vetë, të kategorizuar në oficerë, nënoficerë, ushtarë/detarë dhe civilë, me grada e specialitete të përcaktuara me ligj. Forca rezerviste do të përbëhet nga 2100 vetë. Caktimi në detyrë bëhet në përputhje me tabelat e organizimit dhe pajisjeve të FARSH-ve, ku përparësi kanë repartet operacionale.

5.1.1 Rekrutimi

Procesi i rekrutimit do të përmirësohet dhe do të konsolidohet më tej, duke vendosur dhe duke respektuar kriteret përkatëse, me qëllim sigurimin e transparencës dhe shanseve të barabarta për të gjithë personelin. Rekrutimi do të kryhet sipas nevojave të FARSH-ve dhe ciklit jetësor të personelit ushtarak aktiv dhe rezervist.

Bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe lokale, si dhe me institucionet arsimore dhe shoqërinë civile, vlerësohet si faktor kryesor për të rekrutuar në FARSH kandidatë me kapacitete të larta intelektuale dhe fizike.

5.1.2 Arsimimi dhe trajnimi

Procesi i arsimimit dhe trajnimit do të kryhet në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe ligjin për gradat dhe karrierën e ushtarakut. Ai do të realizohet sipas fazave dhe nevojave për t'i shërbyer rritjes së cilësisë dhe profesionalizmit të personelit ushtarak dhe civil. Ky proces do të zhvillohet në institucionet arsimore dhe të trajnimit, brenda dhe jashtë vendit.

Programet e arsimimit dhe trajnimit të shprehin zhvillimet aktuale e të pritshme në mjedisin e sigurisë dhe kërkesat e shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe komandantëve të komandave kryesore për edukimin, trajnimin, stërvitjen dhe zhvillimin e FARSH-ve.

Sistemi i arsimimit dhe trajnimit të synojë përmbushjen e nevojave sipas specialiteteve dhe kërkesave periodike të strukturave të FARSH-ve për personel ushtarak aktiv dhe rezervist.

5.1.3 Plotësimi me personel i strukturave të FARSH-ve

Plotësimi me personel: oficerë, nënoficerë, ushtarë/detarë dhe civilë i strukturave të FARSH-ve të bëhet në bazë të misionit dhe specifikës së detyrave kryesore që ato kanë, llojit të forcave, gradave dhe specialiteteve. Vëmendje e veçantë t'i kushtohet përzgjedhjes së personelit sipas aftësive profesionale, kohës së qëndrimit në detyrë, specialitetit, performancës, përvojës dhe përkushtimit.

5.1.4 Promovimi

Promovimi në gradë dhe karrierë i personelit ushtarak të realizohet në përputhje me ligjin "Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura", si dhe direktivat, udhëzimet dhe urdhrat e ministrit të Mbrojtjes dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-ve.

Rishikimi i paketës ligjore për menaxhimin e burimeve njerëzore të jetë përparësi e vijueshme, me objektiv shfrytëzimin në maksimum të kapaciteteve intelektuale, rritjen e konkurrencës, motivimin e personelit për zhvillimin e karrierës së tyre dhe funksionimin normal të piramidës së gradave.

5.1.5 Trajtimi i ushtarakëve

Trajtimi i ushtarakëve do të fokusohet në zhvillimin e politikave social-ekonomike të Ministrisë së Mbrojtjes, me synim përmirësimin e trajtimit financiar sipas shkallëve të vështirësive (pagave dhe shtesave për vështirësi shërbimi), të krahasueshme me sektorët e tjerë të administratës shtetërore e të institucioneve të sigurisë së vendit.

Rritja e përkujdesjes ndaj familjeve të ushtarakëve të synojë sigurimin e kushteve për banim, zgjerimin e mjediseve çlodhëse, si dhe krijimin e lehtësirave të tjera për personelin ushtarak dhe familjet e tyre.

5.1.6 Dalja në rezervë dhe në pension

Dalja në rezervë dhe pension i ushtarakëve do të bëhet sipas akteve ligjore në fuqi, me synim integrimin e tyre në jetën civile. Ministria e Mbrojtjes të hartojë dhe zbatojë politika për integrimin në jetën civile të oficerëve në rezervë.

Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm të vazhdojnë praktikatat e rekrutimit të ushtarakëve në rezervë në strukturat e FARSH-ve. Mbështetja dhe integrimi i ushtarakëve në rezervë nga institucionet shtetërore të jetë një proces i vazhdueshëm, me qëllim mundësimin e angazhimit të tyre në dhënien e kontributit për zhvillimin e vendit.

5.2 Burimet materiale

Burimet materiale do të mbështesin veprimtarinë e FARSH-ve dhe konceptin operacional të përdorimit të tyre, në kohë paqeje, krize dhe lufte. Ato përfshijnë fushat kryesore të mbështetjes logjistike dhe fusha të tjera që janë të lidhura ngushtë me logjistikën si: mbështetja shëndetësore, infrastruktura, pronat ushtarake, buxhetimi dhe prokurimi.

Zhvillimi i tyre do të bazohet në burimet materiale të FARSH-ve, burimet materiale shtetërore, si dhe kontraktimin e mallrave dhe shërbimeve që ofrohen nga operatorët privatë dhe

marrëveshjet me agjenci të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me natyrën e operacioneve dhe leverdishmërinë ekonomike.

5.2.1 Mbështetja logjistike

Mbështetja logjistike në FARSH do t'i përgjigjet nevojave kombëtare dhe angazhimeve ndërkombëtare, në kushtet e mundësive të mjedisit të sigurisë, përfshirë ndërveprueshmërinë me sistemin e integruar të logjistikës së NATO-s.

Mbështetja logjistike do të organizohet në tre nivele: nivel taktik (mbështetja e drejtpërdrejtë), nivel operacional (mbështetje e përgjithshme) dhe nivel strategjik. Mbështetja logjistike e nivelit taktik dhe operacional realizohet nga strukturat logjistike të FARSH-ve.

Kjo mbështetje, në nivelin strategjik, bazohet te burimet kombëtare publike, shtetërore dhe private, si dhe ndërkombëtare, të cilat realizohen nëpërmjet marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe midis Republikës së Shqipërisë me vendet e Aleancës dhe ato partnere, të cilat koordinohen nga Ministria e Mbrojtjes dhe SHPFA-ja.

Përparësitë kryesore të mbështetjes logjistike do të jenë:

- a) përmbushja e nivelit të ambicies për operacionet për mbrojtjen e vendit;
- b) plotësimi i kërkesave operacionale të Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë dhe Forcave të Reagimit të Shpejtë dhe Gatishmërisë së Lartë (NRF/VJTF), të deklaruara për t'u vendosur në dispozicion të NATO-s;
- c) zhvillimi i objektivave të kapaciteteve; dhe
- ç) krijimi i kapaciteteve të veçanta.

5.2.2 Infrastruktura

FARSH-të do të administrojnë, zhvillojnë dhe do të mirëmbajnë një infrastrukturë bashkëkohore për jetesë, edukim/stërvitje, mbështetje të operacioneve dhe komandim-kontrollin të strukturave ushtarake në kohë paqeje, krize e lufte.

Ndërtimi i poligoneve të reja dhe përmirësimi i infrastrukturës së atyre ekzistuese, si dhe evidentimi, zhvillimi dhe përmirësimi i kapaciteteve të vendit pritës për forcat e NATO-s, të cilat mund të veprojnë ose kalojnë transit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të mbeten përparësi kryesore.

Përmirësimi, evidentimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i infrastrukturës kritike, me rëndësi strategjike, për të përmbushur detyrimet kombëtare dhe në kuadër të mbrojtjes kolektive, si një detyrim ndërinstitucional dhe i koordinuar nga Ministria e Mbrojtjes, të jetë përparësia kryesore.

5.2.3 Mbështetja shëndetësore

Mbështetja shëndetësore përfshin burimet shëndetësore të FARSH-ve, si dhe burimet kombëtare e ndërkombëtare, të bazuara te marrëveshjet dy ose shumëpalëshe, brenda dhe jashtë vendit.

Përparësia kryesore e mbështetjes shëndetësore të jetë zhvillimi i kapaciteteve mjekësore për realizimin e masave parandaluese dhe trajtimin shëndetësor të personelit të FARSH-ve, me synim mbështetjen e kapaciteteve operacionale. Vijimi i kontributit në nismën rajonale BMTF (Balkan Medical Task Force), si një objektiv i angazhimit rajonal, të mbetet një nga përparësitë kryesore.

Strukturat shëndetësore të vijojnë informatizimin, vlerësimin dhe certifikimin e gjendjes shëndetësore të efektivave të FARSH-ve.

5.2.4 Kapacitetet për emergjencat civile

Ministria e Mbrojtjes dhe FARSH-të të rishikojnë dhe të përshtatin kuadrin ligjor, të reformojnë strukturat planëzuese dhe koordinuese, si dhe të përmirësojnë dhe modernizojnë kapacitetet reaguese për përballimin e emergjencave civile.

Ministria e Mbrojtjes të koordinojë me të gjitha strukturat e tjera shtetërore, ato joshtetërore, si dhe shtetet e organizatat ndërkombëtare që operojnë në fushën e emergjencave civile. Synimet kryesore të jenë marrja e masave parandaluese për ndërgjegjësimin e popullatës, uljen e kohës së reagimit e të kthimit në normalitet të gjendjes, si dhe planifikimin e rezervave të nevojshme materiale.

Ministria e Mbrojtjes të synojë anëtarësimin e vendit në strukturat evropiane të mbrojtjes civile.

5.2.5 Planifikimi i rezervave materiale

Planifikimi dhe krijimi i rezervave materiale të synojë plotësimin e kërkesave për trajnim, gatishmëri dhe për zhvillimin e stërvitjeve dhe operacioneve, bazuar në tempin operacional të FARSH-ve; arritjen e nivelit të ambicies; angazhimin e komponentit rezervist dhe veçanërisht, për angazhimet në operacionet brenda dhe jashtë vendit. Përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor për përdorimin e burimeve kombëtare dhe ndërkombëtare të jetë një nga përparësitë kryesore të zhvillimit të kapaciteteve të rezervave materiale.

5.3 Burimet financiare

Procesi i planifikimit të burimeve financiare do të jetë pjesë përbërëse e Sistemit të Planifikimit, Programimit, Buxhetimit dhe Zbatimit të burimeve financiare të alokuara për mbrojtjen. Planifikimi i burimeve financiare në fushën e mbrojtjes të ruajë raportet ndërmjet kategorive kryesore të shpenzimeve buxhetore, sipas rekomandimeve përkatëse të NATO-s.

Shpenzimet për personelin të jenë të balancuara me kategoritë e tjera të shpenzimeve të mbrojtjes, ndërsa raporti i shpenzimeve për modernizim të arrijë masën 20% të totalit të shpenzimeve për mbrojtjen. Kjo do të krijojë mundësinë e zhvillimit të kapaciteteve të FARSH-ve, duke siguruar modernizimin dhe infrastrukturën e nevojshme të saj. Buxheti i mbrojtjes do të rritet gradualisht nga 1.20% e PPB në vitin 2019, në 2% të PPB në fund të vitit 2024.

5.3.1 Shpenzimet për personelin

Shpenzimet për personelin do të synojnë mbështetjen e gjithë ciklit jetësor të tij, që nga rekrutimi deri në daljen rezervë dhe në pension. Një rëndësi e veçantë do t'i kushtohet mbështetjes sociale të ushtarakëve.

5.3.2 Shpenzimet për operacionet dhe mirëmbajtjen

Shpenzimet për operacionet dhe mirëmbajtjen do të rriten gradualisht për të mbështetur aktivitetin e FARSH-ve. Ky aktivitet përfshin trajnimin, stërvitjen, gatishmërinë, mirëmbajtjen, pjesëmarrjen në operacionet ushtarake, mbështetjen për përballimin e emergjencave civile, ndihmën ndaj komunitetit etj.

5.3.3 Shpenzimet për investimet

Shpenzimet për investimet do të mbështesin procesin e modernizimit të FARSH-ve, si dhe përmirësimin e infrastrukturës ushtarake për punë, jetesë, trajnim, stërvitje etj. Modernizimi do të synojë përbushjen e objektivave të kapaciteteve të NATO-s, si dhe të kapaciteteve të tjera që nevojiten për mbështetjen e veprimtarisë së FARSH-ve si brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

Përparësitë kryesore në modernizim do të jenë: Grup-Batalioni i Këmbëorisë së Lehtë, sistemet e komunikimit dhe informacionit, sistemi i vëzhgimit të hapësirës ajrore e detare, kërkim-shpëtimi, mjetet e transportit, mjetet speciale xheniere, si dhe pajimet bazë për të gjithë ushtarakët e FARSH-ve.

5.4 Arsimimi, trajnimi dhe stërvitja

5.4.1 Arsimimi

Integrimi i sistemit të edukimit ushtarak në sistemin kombëtar të arsimit të lartë, të realizohet nëpërmjet ristrukturimit të institucioneve arsimore ushtarake, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë (LAL) të Republikës së Shqipërisë, me theks të veçantë hartimin dhe miratimin e një pakete të plotë masash ku të gjejnë zgjidhje harmonizimi i veprimtarisë së Akademisë së Forcave të Armatosura me kërkesat ligjore të LAL-së dhe zhvillimi i studimeve në të tria nivelet: bachelor, master dhe doktoraturë, si edhe integrimi i mësimdhënies me punën kërkimore-shkencore.

Bashkëpunimi dhe ndërveprimi me institucionet e arsimit të lartë dhe institucione kërkimore-shkencore brenda vendit dhe të NATO-s apo vendeve aleate, të synojë rritjen e nivelit të vlerësimit dhe reagimit ndaj çështjeve me interes të përbashkët, në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Puna kërkimore të trajtojë çështje që lidhen me ambiciet politiko-ushtarake, monitorimin dhe analizën e mjedisit të sigurisë, zhvillimin e kapaciteteve dhe nivelit të ambicies, zhvillimin e koncepteve operationale dhe atyre të mbështetjes, duke pasqyruar zhvillimet më të fundit në mjedisin e sigurisë dhe standardet e mësimet e nxjerra, si dhe duke bashkëpunuar me institucione studimore brenda dhe jashtë vendit, veçanërisht me vendet aleate të NATO-s. Puna kërkimore shkencore t'i shërbejë rritjes së nivelit të edukimit dhe plotësimit të nevojave të FARSH-ve.

Zhvillimi i mendimit doktrinar të bëhet në përputhje me parimet dhe zhvillimet konceptuale doktrinarë të Aleancës, të realizohet nëpërmjet procesit të rishikimit dhe hartimit të një sërë

publikimesh doktrinave, konceptesh dhe dokumenteve tjera të rëndësishme për funksionimin e FARSH-ve. Menaxhimi i procesit të standardizimit dhe sistemit të mësimave të nxjerra (LL – Lessons Learned), mbetet një nga detyrat kryesore e përhershme.

5.4.2 Trajnimi dhe stërvitja

Trajnimi individual dhe stërvitja kolektive në FARSH të konsiderohen si përparësi të rëndësishme, në përmbushje të misionit kushtetues, Nivelit të Ambicies së FARSH-ve dhe të angazhimeve në kuadër të NATO-s, BE-së dhe OKB-së.

Trajnimi dhe stërvitja të synojë aftësimin e personelit për planëzimin dhe zhvillimin e operacioneve në të gjitha nivelet e komandimit. Fokusi kryesor të jetë zhvillimi i stërvitjes nëpërmjet shfrytëzimit në maksimum të të gjithë potencialit njerëzor dhe infrastrukturor, në të gjitha nivelet, bazuar në misionin, detyrat dhe kushtet reale, për t'iu përgjigjur nivelit të zhvillimit të FARSH*së dhe atyre të Aleancës.

Drejtimet kryesore të trajnimit individual dhe stërvitjes kolektive të FARSH-ve të jenë:

- a) përmirësimi dhe përditësimi i dokumenteve doktrinare, manualeve dhe rregulloreve ushtarake, si dhe zbatimi i standardeve në programet stërvitore;
- b) përmirësimi i infrastrukturës dhe mbështetjes me bazë materiale stërvitore e didaktike bashkëkohore;
- c) përmirësimi i procesit të vlerësimit të gatishmërisë së reparteve, me theks të veçantë të atyre të deklaruara, si pjesë e Forcave Reaguese të NATO-s;
- ç) vijimi i pjesëmarrjes në stërvitjet e përbashkëta me NATO-n, ato rajonale dhe dypalëshe, si dhe shfrytëzimi i përvojës së fituar.

5.5 Bashkëpunimi civilo-ushtarak

Bashkëpunimi civilo-ushtarak (BCU) do të realizohet nëpërmjet ndërveprimit midis aktorëve ushtarakë dhe atyre civilë, brenda një mjedisi operacional gjithëpërfshirës, me synim mbështetjen e veprimtarisë të FARSH-ve. BCU-ja, si një funksion ushtarak dhe pjesë integrale e operacioneve shumëdimensionale, adreson bashkëpunimin ndërmjet të gjithë aktorëve ushtarakë dhe joushtarakë dhe lehtëson realizimin e mbështetjes reciproke të kapaciteteve civile për forcat ushtarake dhe anasjelltas. Qëllimi kryesor i BCU-së të jetë bashkimi i përpjekjeve të të gjithë aktorëve drejt një objekti të përbashkët. Në rastet kur nuk mund të arrihet plotësisht bashkimi i përpjekjeve, ndërveprimi të sigurojë harmonizimin më të madh të mundshëm të veprimtarive të përbashkëta dhe shmangien e konflikteve të padëshiruara ndërmjet aktorëve.

BCU është i zbatueshëm për të gjitha llojet e operacioneve. Drejtuesit ushtarakë të analizojnë në vazhdimësi faktorët socialë, ekonomikë, kulturorë, fetarë, etnikë, mjedisorë dhe humanitarë, gjatë planëzimit dhe zbatimit të planeve operationale, brenda dhe jashtë vendit. Ata duhet të marrin parasysh praninë e një numri të madh të aktorëve civilë në zonën e operacionit, të cilët kanë mandatin, parimet, objektivat, strukturën, metodat, rolin dhe qasjen e tyre, që mund të kenë ndikime në operacione.

5.6 Komunikimi strategjik

Komunikimi strategjik, si instrument i rëndësishëm i lidershit politik dhe ushtarak për arritjen e efekteve të dëshirueshme strategjike, të realizojë transmetimin e mesazheve kyçe për ndikimin e grupeve të caktuara (*target audience*), në interes të përmbushjes së objektivave strategjike, politikave shtetërore dhe angazhimeve ushtarake, brenda dhe jashtë vendit.

Komunikimi strategjik të synojë transmetimin e mesazheve të sakta, të shpejta, në kohën e duhur dhe në mënyrë efektive, duke përdorur kanale të ndryshme komunikimi dhe angazhimi publik, me qëllim ndërjegjësimin, mirëkuptimin dhe mbështetjen për vendimet politike dhe angazhimet ushtarake që do të ndërmerren. Komunikimi strategjik të synojë gjithashtu edhe kundërvënien ndaj propagandës së kundërshtarëve të mundshëm dhe lajmeve të rreme.

Komunikimi strategjik të realizohet nëpërmjet përdorimit efikas e të koordinuar të diplomacisë, çështjeve publike e ushtarake, operacioneve të informimit dhe atyre psikologjike, si dhe krijimit të kapaciteteve të duhura strukturore dhe teknologjike të informacionit e mjeteve të komunikimit.

Komunikimi strategjik të jetë i bashkërenduar me vendet e NATO-s dhe partnerët tanë politikë dhe ushtarakë.

5.7 Modernizimi i sistemit të mbrojtjes

Procesi i modernizimit të FARSH-ve të synojë zhvillimin e të gjithë elementeve materiale, të informacionit dhe teknologjisë, sistemin e komandim-kontrollit, zbulimit dhe inteligjencës, etj., në funksion të sistemit të mbrojtjes dhe sigurisë. Programet e modernizimit të vijojnë të mbështesin zhvillimin, në mënyrë graduale, të kapaciteteve të nevojshme të FARSH-ve.

Prioriteti i modernizimit në periudhën 2019–2025 do të jetë zhvillimi i kapaciteteve:

- të luftimit;
- të mbështetjes së luftimit;
- të mbështetjes me shërbime të luftimit;
- të mbrojtjes kibernetike;
- të vëzhgimit të hapësirës ajrore e detare;
- të kërkim-shpëtimit
- për përballimin e emergjencave civile.

Në fokus të të gjithë procesit të modernizimit të jetë krijimi i formacioneve moderne me pajisje e sisteme të ndërveprueshme me aleatët, për misione dhe detyra brenda dhe jashtë vendit.

KREU VI

SIGURIA NËPËRMJET BASHKËPUNIMIT DHE ANGAZHIMET NDËRKOMBËTARE

6.1 Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes të vijojë në përputhje me programin e qeverisë për politikën e jashtme. Bashkëpunimi ndërkombëtar të mbështesë konsolidimin euroatlantik të vendit, përshpejtimin dhe konkretizimin e proceseve të integritimit në Bashkimin Evropian, forcimin e miqësisë dhe marrëdhënieve me fqinjët, rritjen e rolit, kontributit dhe besueshmërisë së Republikës së Shqipërisë në rajon.

Objektivat kryesorë të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes do të jenë mbrojtja e interesave kombëtarë, parandalimi i konflikteve dhe kontributi për stabilitetin demokratik, në rajon e më gjerë.

FARSH-të të vijojnë të jenë aktive duke kontribuar në forcimin e paqes dhe sigurisë në rajon dhe në botë, nëpërmjet angazhimit të vazhdueshëm në menaxhimin e krizave në operacionet e drejtuara nga NATO-ja, BE-ja dhe OKB-ja.

FARSH-të do të kontribuojnë në nisma të ndryshme ndërkombëtare në luftë kundër terrorizimit ndërkombëtar, ekstremizmit të dhunshëm, në mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë, në masat për rritjen e besimit dhe të sigurisë në kuadrin e OSBE-së, si në çështjet e Armë-Kontrollit, në Dialogun e Strukturuar etj.

FARSH-të të thellojnë bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes me vendet aleate dhe ato partnere, nëpërmjet planeve të bashkëpunimit dypalësh. Ky bashkëpunim të synojë ndërveprimin për çështje të ndryshme ushtarak, e si: arsimimi, stërvitja, pjesëmarrja e përbashkët në operacione, rritja dhe përmirësimi i kapaciteteve të mbrojtjes etj.

6.2 Bashkëpunimi rajonal

Bashkëpunimi rajonal në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes të synojë ruajtjen dhe konsolidimin e stabilitetit, si dhe mbështetjen e proceseve integruese euroatlantike të rajonit.

Fokusi i bashkëpunimit rajonal do të jetë:

- a) mbështetja e integritimit të vendeve të rajonit në NATO;
- b) krijimi dhe zhvillimi i një rrjeti rajonal të sigurisë, në funksion të forcimit të kapaciteteve të shkëmbimit të informacionit ndërmjet vendeve të rajonit për çështje të sigurisë dhe emergjencave civile;
- c) vijimi i angazhimeve dhe përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi i vendit tonë në nismat rajonale, si: SHBA – Karta e Adriatikut (A-5) SEDM, RACVIAC, SEESAC etj.;
- ç) miratimi i akteve nënligjore dhe angazhimeve të tjera që rrjedhin nga anëtarësimi i vendit tonë në nismën e Njësisë Mjekësore Ballkanike (Balkan Medical Task Force).

6.3 Kontributi në operacionet dhe iniciativat ndërkombëtare

Republika e Shqipërisë dhe FARSH do të vijojnë të mbështesin në mënyrë aktive misionet dhe nismat e NATO-s, duke përmbushur të gjitha angazhimet operacionale, në përputhje me tri

detyrat thelbësore të Aleancës: mbrojtja kolektive, menaxhimi i krizave dhe siguria bashkëpunuese, të shprehura në konceptin strategjik të saj.

FARSH-të të vijojnë të angazhohen në misionet e drejtuara nga BE-ja dhe OKB-ja.

Angazhimet në misione do të synojnë një rritje kontributesh si në aspektin sasior, ashtu edhe atë cilësor, me fokus misionet e këshillimit, trajnimit, dhënies së ekspertizës, si dhe ofrimin e kapaciteteve të veçanta.

Ministria e Mbrojtjes dhe FARSH-të të planifikojnë rritje progresive të angazhimeve me kontribute në aktivitete dhe nisma të ndërmarra nga Bashkimi Evropian në fushën e sigurisë e të mbrojtjes, si dhe menaxhimit të krizave. Të vlerësohet angazhimi i mundshëm në konceptin e grup-batalioneve të BE-së, në kuadër të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP).

Shqipëria do të vijojë bashkëpunimin me BE-në në fushën e emergjencave civile, me synim antëtarësim në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian.

KREU VII

PËRFUNDIME

Republika e Shqipërisë po përballet me një mjedis sigurie shumë dinamik rajonal dhe ndërkombëtar. Ky mjedis mund të rezultojë në rreziqe dhe kërcënime që, në mënyrë të paparashikuar, mund të ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë kombëtare.

NATO-ja dhe vendet anëtare të saj kanë njohur plotësisht natyrën dinamike të këtij mjedisi, pasi janë përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në kërcënime, të tilla si: sulmet terroriste, kibernetike dhe operacionet hibride.

BE-ja, nga ana tjetër, po përballet me sfida të reja të sigurisë, si: migracioni i paligjshëm, ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi, si dukuri që paraqesin një rrezik gjithnjë e në rritje ndaj sigurisë.

Refuzimi për të njohur rendin dhe juridiksionin aktual ndërkombëtar, nga aktorë shtetërorë dhe joshetërorë, mund të rrisë mundësitë e konflikteve ushtarake konvencionale dhe jokonvencionale në periferi të kufijve të Aleancës dhe Evropës, ku ndodhet gjeografikisht vendi ynë. Këto kërcënime, për shkak të këtij konteksti politik, historik e gjeopolitik, paraqesin një sfidë për sigurinë kombëtare, për të cilën vendi ynë duhet të përgatitet dhe të reagojë në mënyrë plotësisht të përshtatshme.

FARSH-të të arrijnë nivelin e kërkuar të kapaciteteve operacionale dhe gatishmërisë luftarake për të vepruar në të gjithë spektrin e operacioneve ushtarake. Modernizimi i FARSH-ve dhe zhvillimi i burimeve njerëzore të vlerësohen si tregues cilësorë të kapaciteteve të mbrojtjes.

Republika e Shqipërisë do të ofrojë kontributet e nevojshme për sigurinë dhe mbrojtjen kolektive të NATO-s.

Zhvillimi i burimeve të mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë mbetet një aspekt i rëndësishëm për transformimin dhe modernizimin e FARSH-ve për periudhën 2019–2025. Burimet e mbrojtjes do të mundësojnë realizimin e misionit, detyrave të mbrojtjes së vendit, mbrojtjes kolektive dhe angazhimeve, në kuadër të NATO-s, BE-së, OKB-së dhe koalicioneve me partnerët strategjikë.

Strukturat ushtarake të tregojnë përgjegjshmëri dhe integritet për menaxhimin efikas të burimeve mbrojtjes.

Procesi i planifikimit të mbrojtjes kombëtare të harmonizohet me procesin e planifikimit të mbrojtjes së NATO-s, duke synuar zhvillimin në kohë të objektivave të kapaciteteve dhe gatishmërisë së FARSH-ve për pjesëmarrje në operacionet ushtarake brenda dhe jashtë vendit. Këtij synimi do t'i shërbejë edhe konsolidimi i mëtejshëm i Sistemit të Planifikimit, Programimit, Buxhetimit dhe Ekzekutimit për harmonizimin sa më të mirë të politikave, përparësive, standardeve, proceseve dhe burimeve të mbrojtjes.

Buxheti i mbrojtjes do të vijojë të rritet gradualisht, duke arritur në 2% të PBB në vitin 2024. Shpenzimet për modernizimin të arrijnë masën 20% të buxhetit të mbrojtjes. Të përmirësohet raportin e shpenzimeve, sipas zërave buxhetorë. Ky raport do të sigurojë zhvillimin dhe mbështetjen e personelit, operacionalitetit dhe gatishmërisë, modernizimit dhe infrastrukturës

për jetesë, edukim/stërvitje, mbështetje të operacioneve dhe komandim-kontrollit të strukturave ushtarake në kohë paqeje, krize e lufte.

Programet e modernizimit të vijojnë të mbështesin dhe të zhvillojnë, në mënyrë graduale, kapacitetet operacionale të nevojshme për FARSH-në, pajisjen me armatim, teknikë dhe sisteme të ndërveprueshme me aleatët, për misione dhe detyra brenda dhe jashtë vendit.

Prioritetet e modernizimit në periudhën 2019–2025, të jenë: Grup-Batalioni i Këmbësisë së Lehtë; Sistemi i Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore e Detare; Baza Ajrore Kuçovë; njësia ushtarake e mbrojtjes kibernetike; zhvillimi i kapaciteteve të veçanta (Niche), kapaciteteve të kërkim-shpëtimit dhe kapaciteteve për përballimin e emergjencave civile.

Forca e ardhshme të përmirësohet në terma cilësorë. Mbështetja e të gjithë ciklit jetësor të personelit të vlerësohet si një detyrë e vazhdueshme e strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-ve, duke bërë rregullimet e duhura ligjore, si për personelin aktiv, ashtu edhe për atë në rezervë.

Komponenti rezervist të përbëjë 25% të numrit të përgjithshëm të FARSH-ve. Zhvillimi i këtij komponenti, krijimi i strukturave përkatëse dhe mënyra e përdorimit të tyre rrisin kapacitetet operacionale të FARSH-ve.

Sistemi i edukimit ushtarak të synojë përputhjen sa më të plotë me sistemin kombëtar të arsimit të lartë, duke bërë ristrukturimin e institucioneve arsimore-ushtarake, harmonizimin e mësimdhënies me punën kërkimore-shkencore dhe përsosjen e infrastrukturës didaktike. Bashkëpunimi dhe ndërveprimi me institucionet e arsimit të lartë dhe institucione kërkimore-shkencore, brenda vendit dhe të NATO-s apo vendeve aleate, të synojë rritjen e nivelit të mendimit doktrinar ndaj çështjeve me interes të përbashkët, në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Emergjencat civile të vlerësohen si një fushë e rëndësishme e veprimtarisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe FARSH-ve. Ministria e Mbrojtjes të rishikojë kuadrin ligjor, të reformojë strukturat planëzuese dhe koordinuese, si dhe të zhvillojë kapacitetet reaguese për përballimin e emergjencave civile. Koordinimi me të gjitha strukturat e tjera të synojë marrjen e masave parandaluese, masat për ndërgjegjësimin e popullatës, për uljen e kohës së reagimit dhe të kthimit në normalitet të gjendjes, si dhe planifikimin e rezervave të nevojshme materiale.

Anëtarësimi i vendit tonë në strukturat evropiane të mbrojtjes civile mbetet një ndër synimet kryesore për të dimensionuar më tej planifikimin dhe përballimin e pasojave që vijnë nga katastrofat natyrore.

Përmirësimet ligjore të mbështesin zhvillimin e mëtejshëm dhe afatgjatë të sistemit të mbrojtjes, me qëllim përmbushjen e nivelit të ambicies së FARSH-ve dhe përshtatjen me legjislacionin e NATO-s/BE-së, në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes.

Spektri gjithëpërfshirës i sigurisë dhe mbrojtjes kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm ndërinstitucional, për të koordinuar veprimet, për të siguruar kapacitetet e duhura dhe për të vepruar në kohën dhe vendin e duhur, në çdo lloj situatë. Kapacitetet operacionale të FARSH-ve të harmonizohen dhe të integrohen me elementë të tjerë të fuqisë kombëtare, si dhe të rrisin ndërveprueshmërinë me forcat e Aleancës.

Synimi kryesor i zhvillimit të FARSH-ve të jetë përshtatshmëria dhe aftësia për të përballuar skenarët e përshkruar në këtë dokument, përfshirë përballimin e disa skenarëve që mund të ndodhin njëkohësisht.

FARSH-të të jenë të afta të sigurojnë pavarësinë, sovranitetin dhe tërësinë territoriale të vendit dhe rendin kushtetues; përmbushjen e detyrimeve, në kuadër të mbrojtjes kolektive; pjesëmarrjen në operacionet e drejtuara nga NATO-ja; përballimin e emergjencave civile, në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore.